



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I FINANCËS

Nr.454/1 Prot

Pustec më 24.03.2026

PROJEKT-VENDIM
Nr.7 Datë 24.03.2026

PËR KRIJIMIN E NJË ASETI TË RI NGA BASHKIMI I LLOGARIVE FINANCIARE

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi shqyrtoi relacionin shpjegues, vendosi ti propozojë Këshillit Bashkiak:

TË MIRATOJ

1. Krijimin e një aseti të ri në inventarin e pasurive të Bashkisë Pustec, nga bashkimi i llogarive financiare që lidhen me investimin për furnizimin me ujë.
2. Llogaritë që bashkohen janë:
 - Objekti “Furnizim me ujë B. Pustec” 540,799,533 lekë
 - Mbikëqyrje punimesh furnizim me ujë 4,324,340 lekë
 - Kolaudator punimi 671,258 lekë
 - Studime dhe projektimi 15,828,724 lekë
 - Lidhje të reja për kabina elektrike në gjashtë fshatra 921 120 lekë
3. Vlera totale e asetit të ri përcaktohet në shumën **562,544,975 lekë**.
4. Ngarkohet Sektori i Financës dhe strukturat përgjegjëse për:; pasqyrimin e saktë në regjistrat kontabël; ndjekjen e procedurave për amortizimin dhe administrimin e mëtejshëm të tij.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe zbatohet nga strukturat përkatëse të Bashkisë Pustec.

PËRGJEGJËS I FINANCËS
Cvetko NASTO

KRYETAR I BASHKISË
Pali KOLEFSKI

